



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË / MINISTARSTVO EKONOMIJE / MINISTRY OF ECONOMY

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës/ Geološka Sluzba za Kosovo/ Geological Survey of Kosovo

REFERENCË:	SHKRESE PËRCJELLËSE				
PËR/ZA/TO:	Znj. Artane Rizvanolli, Ministre, ME <i>Artane 30.12.2022</i>				
CC:	Znj. Leonita Shabani, Zëvendës Sekretare e Përgjithshme, ME Znj. Anyla Beqa, Shefe e kabinetit, ME				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Luan Morina, Zëvendës Drejtor Ekzekutiv, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, ME <i>[Signature]</i>				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Planin e Performancës se Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2023				
Nr. i zyrës:	01	Lokacioni:	SHGJK	Data:	22.12.2022
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input checked="" type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input checked="" type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					31.12.2022

E nderuara Ministre Rizvanolli,

Përmes kësaj shkrese ju njoftoj se Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, ka hartuar Planin e Performancës se Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në

Rregulloren (QKR) nr.03/2020 për Performancën e Agjencive, e cila buron nga Ligji Nr. 06/1-133 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Në vijim keni:

Planin e Performancës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy
Shërbimi Gjeologjik i Kosovës
Geološka služba Kosova - Kosovo Geological Service

**PLANI I PËRFORMANCËS SË
SHËRBIMIT GJEOLOGJIK I KOSOVËS
PËR VITIN 2023**

Punuar nga:
Luan Morina,
Zëvendës Drejtor Ekzekutiv,
Shërbimi Gjeologjik i Kosovës

A. Pjesa përshkruese e Planit të Performancës

1. Përmbledhje Ekzekutive

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, bazuar në Ligjin nr. 06/l -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, ndërsa bazuar në Ligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, është përgjegjëse për:

- 1.1 kryerjen e hulumtimeve themelore gjeologjike dhe hulumtimeve aplikative gjeologjike;
- 1.2. kryerjen e studimeve gjeologjike sistematike bazë në tokë, në liqene, nëpërmjet hartografimeve komplekse të shkallëve të ndryshme;
- 1.3. kryerjen e studimeve gjeokimike dhe përpilimin e hartave gjeologjike në shkallë të ndryshme, si dhe plotësimin e hartave ekzistuese me informacione të reja;
- 1.4. kryerjen e studimeve të thelluara shkencore për gjeologjinë dhe metalogjeninë;
- 1.5. kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve gjeofizike të çdo shkalle me qëllim të studimit të korës së tokës në ose në afërsi të sipërfaqes së tokës;
- 1.6. kryerjen e studimeve për promovim të perspektivës së mineraleve të dobishme dhe vlerësimin ekonomik të tyre;
- 1.7. kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve hidrogjeologjike, ujërave nëntokësore, ujërave minerale dhe gjeotermal;
- 1.8. kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve gjeologo-inxhinierike dhe të gjeorrezive;
- 1.9. kryerjen e studimeve gjeologjike komplekse për gjeomjedisin në funksion të planifikimit të territorit;
- 1.10. kryerjen e studimeve dhe vlerësimeve të gjeomonumenteve;
- 1.11. kryerjen e hulumtimeve dhe vlerësimeve të mineraleve metalore, jo metalore, energjetike, hidrokarbureve, mineraleve industriale, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar;

1.12. kryerjen e hulumtimeve dhe studimeve të përgjithshme paleontologjike, stratigrafike, sedimentologjike, petrografike, mineralogjike, kimike, gjeomorfologjike, gjeodinamike, gjeologjiko strukturore dhe gjeostatistike;

1.13. përpilimin apo plotësimin e hartave gjeologjike në shkallë të ndryshme, harta gjeologjike tematike (metalogjenike, mineralmbajtëse, gjeokimike, hidrogeologjike, gjeologo-inxhinierike, strukturo-tektonike, sizmike, gjeomonumenteve, gjeoekologjike, përfshirë edhe përgatitjen e bazës gjeologjike për nevojat e planifikimit hapësinor, hulumtime dhe monitorimin e rrëshqitjeve të tokës, përgatitjen e hartave gjeologjike të rrezikut, hulumtimet regjionale gjeofizike, analiza dhe hulumtime laboratorike në fushat e mineralogjisë, petrografisë, sedimentologjisë, paleontologjisë, kimike, analiza gjeomekanike;

1.14. kryerjen e studimeve dhe punimeve zhvillimore, të hulumtimeve gjeo-shkencore dhe projekte ndërkombëtare në fushën e gjeologjisë, studimin e ujërave nëntokësore në bazë të programeve të veçanta, mbledhjen, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe dokumentacionit teknik me interes për sistemin e bazës së të dhënave gjeologjike të Republikës së Kosovës;

1.16. krijimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave gjeologjike, e cila duhet të jetë në dispozicion të Qeverisë si dhe subjekteve të tjera të interesuara për hulumtime gjeologjike;

1.17. ofron analiza objektive dhe të paanshme për autoritetet publike dhe organizatat e sektorit privat brenda fushës së ekspertizës së SHGJK-së;

1.18. promovon kristalet e mineraleve, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar të Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça”;

1.9. krijon, mirëmban, pasuron dhe zgjeron bazën shtetërore e të dhënave për kristalet dhe mineralet, fosilet, gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar;

1.10. hulumtime dhe studime mbi zvogëlimin e ndotjes së mjedisit nga aktivitetet minerare;

1.11. Menaxhon me rrjetin Sizmologjik të Kosovës, monitoron aktivitetin sizmik të vendit dhe rajonit, bën studime makro dhe mikro sizmologjike sipas kodeve të aplikuara në Kosovë, si dhe detyra dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, përgjegjëse për sektorin e gjeologjisë, për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë themelore të saj, të përcaktuara me Ligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe legjislacionin në fuqi, Planin e Performancës për vitin 2023, e ka përgatitur duke marrë parasysh burimet njerëzore dhe teknike në dispozicion si dhe mundësitë financiare.

2. Hyrje

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, ka hartuar Planin e Performancës, duke u bazuar në Rregulloren (QKR) nr.03/2020 për Performancën e Agjencive, e cila buron nga Ligji Nr. 06/1-133 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Plani i Performancës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, ndërlidhet me objektivat e punës së Ministrisë së Ekonomisë, mandatin dhe përgjegjësitë ligjore të përcaktuara me Ligjin për shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe dokumentet e politikave sektoriale.

Për të ngritur performancën e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, në këtë plan të performancës janë planifikuar pesë objektiva, të cilat konsiderohen të domosdoshme, të ndarë në dy pjesë, pjesa përshkruese dhe pjesa tabelore, e hartuar sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/1-133 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe Rregulloren (QRK) NR. 03/2020 për performancën e agjencive.

Përmes objektivave të planifikuar në këtë plan të performancës, synohet identifikimi i paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në Njësinë Tektonike të Sharrit, përpilimi i kadastrit përkatës, monitorimi i ngjarjeve sizmike, përpilimi i hartës së shpërndarës së intensitetit sizmik maksimal për territorin e Kosovës për vitin 2023, digjitalizimi dhe vektorizimi i hartave, krijimi dhe digjitalizimi i të dhënave për rrjedhat lumore, dhe pasurimi i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça” me kristale të reja.

Për realizimin e këtij plani të performancës për vitin 2023, sfidë mund të konsiderohet numri tejet i vogël dhe i pamjaftueshëm i stafit profesional, duke pas parasysh së për kryerjen e hulumtimeve gjeologjike, përfshirë rlevimin gjeologjik, hartografimin, monitorimin e ngjarjeve sizmike dhe rrëshqitjeve, si dhe krijimi dhe digjitalizimin e të

dhënave për rrjedhat lumore, kërkohet staf adekuat profesional i profilizuar dhe me eksperiencë përkatëse.

3. Përmbledhje e Objektivave

Objektivat e përcaktuara për vitin 2023 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës janë:

1. Identifikimi dhe evidentimi i mëtejshëm i potencialeve mineralogjike në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës
2. Monitorimi, evidentimi dhe vlerësimi i ngjarjeve që lidhen me Gjeorreziket
3. Krijimi dhe digjitalizimi i të dhënave për rrjedhat lumore;
4. Promovimi dhe Pasurimi i mëtejshëm me kristale /minerale i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça”
5. Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike si dhe bashkëpunimi dhe mbështetja e aktivitetet e karakterit zhvillimore në nivel vendore dhe ndërkombëtar

Objekti 1: Identifikimi dhe evidentimi i mëtejshëm i potencialeve mineralogjike në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës

Përmes këtij objekti, synohet përmbledhja në tërësi e informacioneve të nevojshme për të gjitha paraqitjet me fokus të xeherorë të kromit të cilat janë të njohura nga koha e zbulimit të tyre si dhe finalizimi i Plansheti Gjeologjik i Ponoshecit në shkallë 1: 25000. Për të arritur një objektiv i tillë është e nevojshme krijimi i kadastrit i cili do të mbulon tërë pjesën tektonike të Sharrit, i cili do të krijohet duke shfrytëzuar gjithë dokumentacionin gjeologjik ekzistues të hulumtimeve nga e kaluara, dhe përmes punimeve me rilevim direkt në terrenet ku ato janë të evidentuara.

Hapësira e cila do mbulohet gjatë vitit 2023, gjysma, pra 50% i territorit të definuar e që ka shtrirje prej Hanit të Elezit deri në Kufirin Kosovë-Shqipëri derisa në gjerësi ka hapësirë prej kufirit Kosovë Maqedoni e Veriut gjerë në Zonat kadastrale të Ferizajt, Suharekës dhe Prizrenit. Gjithashtu, do të vazhdohet tutje me aktivitetet që kanë për qëllim krijimin e informacioneve relevante për kompletimin e Plansheti Gjeologjik i Ponoshecit në shkallë 1: 25000 andaj aktivitetet që planifikohen me qëllim të realizimit të këtij objekti janë:

1.1: Krijimi i kadastrit të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit

1.2: Finalizimi i Planshetit të Ponoshecit, në shkallë 1: 25000

Aktiviteti 1.1: Krijimi i kadastrit të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit

- Shqyrtimi i dokumentacioneve ekzistuese nga hulumtimet gjeologjike në të kaluarën;
- Punimet fushore;
- Punimet kabinetike.

Lidhur me aktivitetin e parë, përkatësisht shqyrtimin e dokumentacioneve ekzistuese nga hulumtimet gjeologjike në të kaluarën, do të bëhet identifikimi i dokumenteve relevante ekzistues në posedim të Shërbimit Gjeologjik i Kosovës si dhe institucionet tjera relevante. Pas identifikimit, do të behët adaptimi i të dhënave të nevojshme, për të vazhduar tutje me verifikimin e tyre në teren. Ndërsa sa i përket aktivitetit të dytë dhe të tretë të këtij objekti, përmes shkeljes së terrenit, dhe punimeve kabinetike, do të:

- Identifikohet numri i paraqitjes xeherore në korrelacion me numrin e hartës(nëse ekziston);
- Verifikohen koordinatat qendrore të paraqitjes xeherorë;
- Bëhet përshkrimi i shkurtër i mineralogjisë, petrologjisë;
- Bëhet përshkrimin e karakteristikave fizike të paraqitjes;
- Bëhet përshkrimi i elementeve strukturale;
- Bëhet përshkrimi i vëllimit të paraqitjes xeherore;
- Bëhet përshkrimi i ndikimit të tektonikës;
- Bëhet përshkrimi i nivelit të zbulimit (dobët, pjesërisht apo tërësisht i zbuluar);
- Bëhet përshkrimi i shkëmbinjve rrethues.

Ky aktivitet, si tërësi do të realizohet brenda periudhës dy vjeçare (2023, 2024), me ç'rast synohet që pesëdhjetë përqindëshi (50%) i tërësisë së objektit të realizohet brenda vitit të parë ndërsa, pjesa tjetër, përkatësisht objekti i tërësishëm të përmbyllet në dhjetorë të vitit 2024.

Aktiviteti 1.2: Finalizimi i Planshetit të Ponoshecit, në shkallë 1: 25000, proces ky që do të fokusohet në vazhdimin tuje me aktivitetet dhe atë duke analizuar tërë dokumentacionin gjeologjik ekzistues relevant me qëllim të hulumtimeve nga e kaluara, si dhe përmes punimeve me rilevim direkt në terrenet, përpunimit dhe analizimit të mostrave do të krijohen informacionet relevante për kompletimin e Plansheti Gjeologjik i Ponoshecit në shkallë 1: 25000, duke u fokusuar në hapat si ne vijim:

- 2.1 Hulumtimi dhe shfrytëzimi i dokumentacionit gjeologjik historik për përpilimin e projektit nga hulumtimet e më hershme
- 2.2 Realizimi i punime fushore
- 2.3 Realizimi i punimeve laboratorike
- 2.4 Realizimi i punime kabinetike, si dhe
- 2.5. Teksti sqarues dhe krijimi i hartës përkatëse të Ponoshecit në shkallën 1:25000

Në tersi, ky objektivi, do të realizohet nga nëpunësit e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe nuk paraqet implikime buxhetore shtesë.

Objektivi 2: Monitorimi, evidentimi dhe vlerësimi i ngjarjeve që lidhen me gjeorreziket

Konsideruar që gjeorreziket, përkatësisht ngjarjet sizmike dhe rrëshqitjet, janë aktivitete gjeologjike të cilat potencialisht mund të shkaktojnë rrezik për dëmtimin e pronës por potencialisht edhe humbjen të jetës, monitorimi, vlerësimi dhe evidentimi i tyre është pjesë e përgjegjësisë së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, duke marr parasysh se territori i Republikës së Kosovës, karakterizohet me një ndërtim të komplikuar gjeologjik i shprehur me prezencën e shkëmbinjve me përbërje e moshë gjeologjike të ndryshme, strukturave të ndryshme tektonike, si ato shkëputëse dhe rrudhoseshe e cila lidhet me fushën e studimeve të gjeorreziqueve dhe sizmotektonike për territorin e vendit, i cili këtë mes e përfaqëson sipërfaqja e kores tokësore, brendia e tokës dhe fenomenet të cilat lindin në brendi të saj, manifestohen në forma të ndryshme në sipërfaqen e saj.

Këto ndryshime të shumta morfologjike rrjedhin si pasojë e ndërtimit gjeologjik të komplikuar, veprimtarisë së shprehur të lëvizjeve tektonike dhe proceseve eroduese, e cila rezulton me rrezikshmëri të lart në aspektin gjeorreziqueve dhe atë sizmotektonik.

Ky objektiv do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

2.1 Monitorimi dhe mirëmbajta i rrjetit sizmik dhe përpilimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensitetit maksimal sizmik

2.2 Monitorimi dhe vlerësimi i rrëshqitjeve

Aktiviteti 2.1: Monitorimi dhe mirëmbajta i rrjetit sizmik dhe përpilimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensitetit maksimal sizmik

Ky aktivitet do të behet duke bërë monitorimi dhe mirëmbajtjen të rregullt të rrjetit sizmike në tërë territorin e Kosovës në nivelin makro përmes pajisjeve sizmologjike që janë të vendosura në 6 lokacione të ndryshme në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, në bazë të dhënave të gjeneruara nga ky proces, në baza vjetore do të behet edhe përpilimi i hartës për shpërndarjen e intensitetit maksimal, në këtë rast për vitin 2023. Gjithashtu, si rezultat i kompletimit me pajisje shtese specifike (sistemi së bashku me gjeofonat), SHGJK do të mund të ofrojmë analiza të karakterit sizmike të nivelit mikro edhe për lokacione specifike, varësisht nga kërkesat .

Ky aktivitet do të mbulohet me kapacitetet të kuadrove që ka Departamenti i Gjeoinformacionit dhe Gjeoteknikës

Aktiviteti 2.2: Monitorimi dhe vlerësimi i rrëshqitjeve

Ky aktivitetet ka për qëllim sigurimin e informacionit relevant për monitorimin e gjeorrezizive, përkatësisht të zonave me rrezik të mundshëm që mund të qojnë në fatkeqësi (rrëshqitjet, rrokullisjet, shembjet, rrjedhja e mbeturinave, kolapsi sipërfaqësor, ulja e tokës, thyerje e tokës, erozioni) etj.

Gjithashtu edhe ky aktivitet do të mbulohet me kapacitetet profesionale dhe teknike që ka Departamenti i Gjeoinformacionit dhe Gjeoteknikës, përkatësisht SHGJK.

Objektivi 3: Krijimi dhe digjitalizimi i të dhënave për rrjedhat lumore

Ndërtimi i rrjetit hidrogjeologjik nëntokësorë dhe sipërfaqësor, është një ndër detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, ku krahas hulumtimeve të materialeve

ekzistuese, hulmtimeve dhe daljeve në teren, kërkohet që të behet evidentimi i rrjedhjeve lumore në tërë territorin e Kosovës.

Ky objektivi do të realizohet përgjatë vitit 2023-2024 përmes këtyre aktiviteteve:

3.1 Evidentimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit ekzistues gjeologjik dhe hidrogjeologjik për rrjedhat lumore;

3.2 Krijimi i bazës së të dhënave për rrjedhat lumore;

Aktiviteti 3.1: Evidentimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit ekzistues gjeologjik dhe hidrogjeologjik për rrjedhat lumore; do të behet përmes analizimit të dokumenteve historike që kemi në arkivin e SHGJK -së. Gjithashtu, do të konsultohen edhe dokumentet tjera relevante. E tërë puna që do të zhvillohet në kuadër të këtij aktiviteti do të jetë pune që do të mbulohet nga kapacitetet aktuale që ka departamenti i Sedimentologjisë, përkatësisht SHGJK.

Aktiviteti 3.2: Krijimi i bazës së të dhënave për rrjedhat lumore; nga procesi analitike që do të bëhet përmes analizimit të dokumentacionit relevant, të dhënat që do të krijohen, do të vendosen në një platformë adekuatë e cila mundëson përpunimin e mëtejshëm të tyre.

Gjithashtu, ky aktiviteti do të mbulohet nga stafi aktuale që ka departamenti i sedimentologjisë.

Në raste të caktuara, sipas nevojës do të mbështetet edhe nga strukturat tjera të SHGJK

Objektivi 4: Promovimi dhe Pasurimi i mëtejshëm me kristale /minerale te Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça”.

Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça”, posedon një numër të madh të kristaleve/mineraleve të mbledhur ndër vite, mirëpo pasurimi i muzeut me kristale/minerale të reja, është domosdoshmëri, marr parasysh së fundi ekzistues i kristaleve/mineraleve me përbërje metalore sulfide ndikohen nga oksidimi me pasoj shkatërrimi. Andaj përmes këtij objektivi, do të bëhet pasurimi i fondit ekzistues të kristaleve/mineraleve me strukturë të mirë dhe të veçantë kristalore, dhe po ashtu do të zëvendësohen kristalet tashme të oksiduara dhe të cilat nuk kanë vlerë reprezentative si

dhe do te vazhdohet tutje ne ekspozimin dhe promovimin e tyre përmes aktiviteteve relevante me qëllim të prezantimit i kristaleve/mineraleve në Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça,.

Ky objektivi do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

4.1. Mbledhja, trajtimi dhe restaurimi i kristaleve/mineraleve për qëllime të ekspozimeve të tyre;

4.2. Prezantimi i kristaleve/mineraleve në Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucionalë për qëllime të promovimit të mëtejme të tyre

Aktiviteti: 4.1: Mbledhja, trajtimi dhe restaurimi i kristaleve/mineraleve për qëllime të ekspozimeve të tyre

Ku aktivitet do të fokusohet në trajnimin e kristaleve dhe mineraleve ekzistuese por edhe të atyre të reja, ku në mes tjerash ka për qëllim pasurimin i mëtejme i fondit të muzeut shtetërorë të kristaleve dhe mineraleve “Trepça”. Ky aktivitetet do të mbulohet me kapacitete aktuale/ në dispozicion, andaj edhe si rrjedhojë nuk do të ketë implikime financiare përtej planifikimeve aktuale.

Aktiviteti: 4.2: Prezantimi i kristaleve/mineraleve në Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucionalë për qëllime të promovimit të mëtejme të tyre

Në kuadër të këtij aktiviteti , fokusit do të jetë në funksion të promovimit të mëtejme të sektorit minerare, fokusit do të jetë në prezantimin e kristaleve dhe mineraleve të ekzpozuar ne Muzeun shtetërorë të kristaleve dhe mineraleve “Trepça”. Gjithashtu, komfor mundësive në dispozicion, do të ketë mbështetje të gjitha organizimeve relevante brenda dhe jashtë vendit. Ky proces do të bazohet në kapacitetet e kuadrove dhe atyre financiare në dispozicion gjate vitit 2023.

Objektivi 5: Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike si dhe bashkëpunimi dhe mbështetja e aktivitetet e karakterit zhvillimore ne nivel vendore dhe ndërkombëtar

Referuar përgjegjësisë se Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, është e nevojshme të evidentohet edhe përfaqësimi dhe pjesëmarrja përmes dhënies së kontributit në proceset që lidhen me institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare, andaj edhe bashkëpunimi vendore dhe ndërkombëtar, konsiderohet gjithashtu si objektivi i rëndësishme dhe që do të implementohet në vijimësi në baza vjetore.

Ky objektivi do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

5.1. Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike

5.2. Mbështetja e aktivitetet të karakterit zhvillimore, në nivel vendore dhe ndërkombëtar

Aktiviteti 5.1: Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike; do të fokusohet tek ato të karakterit mineralogjik, kimik dhe fizike do të behet përmes kompletimit dhe funksionalizimit të plotës të pajisjeve të dedikuara për nevojat e SHGJK. Shërbimet e ofruara nga SHGJK do të jen të fokusuar për nevojat studimore të SHGJK, por edhe si mbështetje e aktiviteteve të ndryshme të paraqitura nga aktorëve të ndryshme në sektorin publik dhe private në Republikën e Kosovës dhe me gjere.

Këto shërbime do të ofrohen kryesisht me kapacitetet kuadrore dhe teknike që priten të ndërtohen sipas procedurave relevante siç janë ato të miratimit të rregullores së re të punës së SHGJK, zhvillimin e procedurave për regrutimit të ri të stafit etj. vendime këto që priten të merren gjatë vitit 2023. Buxheti i nevojshme për realizimin e këtij aktiviteti tashmë është i planifikuar për pjesën e kompletimit dhe funksionalizimit të plotës të pajisjeve të dedikuara për nevojat e SHGJK. Ndërsa për pjesën e miratimit të rregullores së re të SHGJK dhe regrutimit të stafit të ri do të trajtohen komfor mundësisë buxhetore të planifikuar për vitin 2023.

Aktiviteti 5.2: Mbështetja e aktivitetet e karakterit zhvillimore në nivel vendore dhe ndërkombëtar; do të behet përmes përfaqësimit institucional me qëllim të ofrimit të kontributit profesional dhe teknike të SHGJK-së. Dy nga zhvillimet kryesore që planifikohet të jenë në funksion të implementimit të këtij aktiviteti do të jen të fokusuar

në ato të karakterit vendore me fokus tek implementimi obligimeve të memorandumit të lidhura për hulumtimin e ujërave nëntokësorë si dhe të atyre ndërkombëtarë, sipas vendimit relevante të marr për pjesëmarrjen / përfshirjen e Republikës e Kosovës, përkatësisht të SHGJK-së, në projektin Shërbimin Gjeologjik për Evropë (GSEU).

4. Ndikimi Buxhetor

Realizmin e objektivave 1, 2, 3 dhe 4 në kuadër të planit të performancese së SHGJK për vitin 2023 kryesisht do të mbulohet me angazhimin e stafit të SHGJK, si dhe duke marr në konsideratë parakushtin për funksionalizimin e aseteve / pajisjeve teknike sipas planifikimeve , por edhe të atyre logjistike që lidhen kryesisht me makinat e terrenit.

Andaj, ndikimi buxhetore do të jete në linje me planifikimet e rregullta buxhetore që kryesisht lidhen me pagat dhe mëditjet si dhe alokimet buxhetore që kryesisht lidhen me kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Gjithashtu, ndikim buxhetore do të këtë edhe tek procesi i implementimit te objektivit te 5, ku buxheti i nevojshëm kryesisht do të duhet te sigurohet tek kategoria e kapitaleve si rezultat i obligimeve të krijuara ne 2022 (konkretisht me 8 Nëntor 2022) ku është bërë nënshkrimi i kontratave, në funksion të implementimit të projektit për furnizimit dhe funksionalizmin e pajisjeve laboratorike të SHGJK. Andaj nga obligimi total prej 497.008.62 Euro, sa ka qen buxheti i alokuar ne vitin 2022, janë shpenzuar rreth 135,099.62 Euro, ndërsa për vitin 2023 mbetet obligimi financiare prej 361,909.00 Euro. Aktualisht në planifikimet buxhetore ne vitin 2023 janë alokuar rreth 237.000, 00 Euro, prandaj pjesa tjetër rreth 125.000,00 Euro, mbete të definohet pasi të përfundoj viti buxhetor 2022, pritet te bëhet rialokime për pjesën e buxhetit të nevojshme për vitin 2023 për mbulim e kostove për implementimin e projektit ne fjale, si rezultat i trajtimit me prioritet i obligimeve të bartura nga viti paraprak.

B. Pjesa tabelore e Planit të Përfundimit të SHGJK për vitin 2023

1. Identifikimi dhe evidentimi i mëtejshëm i potencialëve mineralogjike në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës
2. Monitorimi, evidentimi dhe vlerësimi i ngjarjeve që lidhen me Gjeorrezin
3. Krijimi dhe digjitalizimi i të dhënave për rrjedhat lumore;
4. Promovimi dhe Pasurimi i mëtejshëm me kristale /minerale i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça”
5. Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike si dhe bashkëpunimi dhe mbështetja e karakterit zhvillimor në nivel vendor dhe ndërkombëtar

PLANI I PËRFORMANCËS SË SHERBIMIT GJEOLLOJIK TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

B. Pjesa tabelare e Planit të Përformancës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës - Viti 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë (baseline)	Caku
I.	Objektivi 1: Identifikimi dhe evidentimi i mëtejshëm i potencialeve mineralogjike në zonën jugperëndimore të Republikës së Kosovës		
1	Treguesi i përformancës: Kadastrat i krijuar në masën prej 90% të hapësirës së definuar për vitin 2023 në zonë e Sharrit si dhe finalizimi në tersi (100%) i Planshetit të Ponoshecit në shkallë 1:25000	TM4 2023	
Nr.	Aktiviteti	Buxheti ¹	Produkti (Output)
1.1	Krijimi i kadastrit të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit	23,793.00	Kadastrat i krijuar në masën prej 90% të hapësirës së definuar për vitin 2023 e të paraqitjeve xeherore të mineralit të kromit në njësinë tektonike të Sharrit
1.2	Finalizimi i Planshetit të Ponoshecit, në shkallë 1: 25000	23,793.00	Plansheti të Ponoshecit e finalizuar si tersi duke nënkuptuar edhe finalizimin e tekstit sqarues dhe krijimi i hartës përkatëse të Ponoshecit
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 1:	47,586.00	BRK

¹ Buxheti është i përfaqësuar // është kalkuluar duke marrë në konsideratë pagat e zyrtareve dhe derivate të shpenzuara për realizimin e aktivitetit në fjalë dhe do të mbulohej nga planifikimet e rregullta për paga dhe buxheti i alokuara në vitin 2023 në kategorinë mallra dhe shërbime. Prandaj, nuk pritet buxhet shtese përtej planifikimeve të rregullta buxhetore.

PLANI I PERFORMANCËS SË SHERBIMIT GJEOLOGJIK TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë (baseline)	Caku
II.	Objektivi 2: Monitorimi, evidentimi dhe vlerësimi i ngjarjeve që lidhen me Gjeorrezizqet		
1	Treguesi i performancës: Finalizimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensiteti maksimal sismik për vitin 2022 si dhe përpilimi i së paku 25 raporteve për monitorimin e rrëshqitjeve	TM4 2023	
Nr.	Aktiviteti	Buxheti ²	Produkti (Output)
1.1	Monitorimi dhe mirëmbajta i rrjetit sismik dhe përpilimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensiteti maksimal sismik	13,062.36	Finalizimi i hartës vjetore të shpërndarjes së intensiteti maksimal sismik për vitin 2022 si dhe Monitorimi ne vijimësi dhe vizita e së paku 2 herë të stacioneve sismike me qëllim të mirëmbajtjes së tyre
1.2	Monitorimi dhe vlerësimi i rrëshqitjeve	16,313.23	Monitorimi dhe vlerësimi i rrëshqitjeve në së paku 25 lokacione dhe përgatitja e raporteve për rekomandim të masave përkatëse
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:	29,375.59	BRK

² Buxheti është i përafërt // është kalkuluar duke marrë në konsideratë pagat e zyrtareve dhe derivate e shpenzuara për realizimin e aktivitetit në fjalë dhe do të mbulohej nga planifikimet e rregullta për paga dhe buxheti i alokuara në vitin 2023 në kategorinë mallra dhe shërbime. Prandaj, nuk pritet buxhet shtese përtej planifikimeve të rregullta buxhetore.

PLANI I PERFORMANCËS SË SHERBIMIT GJEOLGJIK TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë (baseline)	Caku
III.	Objektivi 3: Krijimi dhe digitalizimi i të dhënave për rrjedhat lumore		
1	Treguesi i performances: Analizimi dhe krijimi i data bazës përkatëse për futjen e të dhënave në masën së paku prej 70%	TM4 2023	x
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit
			Buxheti ³
1.1	Evidentimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit ekzistues gjeologjik dhe hidrogeologjik për rrjedhat lumore	Departamenti i Sedimentologjise	TM1-TM4 2023
			2,966.82
			BRK
			Dokumentacioni ekzistues historikë gjeologjikë i shqyrtuar në masën së paku prej 70%
1.2	Krijimi i bazës së të dhënave për rrjedhat lumore	Departamenti i Sedimentologjise	TM1-TM4 2023
			2,908.32
			BRK
			Krijimi i data bazës dhe futja e të dhënave në masën prej së paku prej 70%
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 3:		5,875.14
			BRK

³ Buxheti është i përafërt // është kalkuluar duke marrë në konsideratë pagat e zyrtareve dhe derivate e shpenzuara për realizimin e aktivitetit në fjalë dhe do të mbulohej nga planifikimet e rregullta për paga dhe buxheti i alokuara në vitin 2023 në kategorinë mallra dhe shërbime. Prandaj, nuk pritet buxhet shtese përtej planifikimeve të rregullta buxhetore.

PLANI I PERFORMANCËS SË SHERBIMIT GJEOLOGJIK TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë (baseline)	Caku
IV.	Objektivi 4: Promovimi dhe Pasurimi i mëtejshëm me kristale /minerale i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça"		
1	Treguesi i performancës: Nga fondit ekzistues, trajtim dhe restaurimi i së paku 30 % si dhe pasurimi i mëtejshëm i muzeut me kristaleve dhe minerale të reja në masën prej së paku 10% si dhe pritja dhe prezantimi me qëllim të promovimit të ekzemplarëve të ekspozuara në Muze para se paku 20 vizitave të realizuara nga vizitor të ndryshme	TM4 2023	x
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit
1.1	Mbledhja, trajtimi dhe restaurimi i kristaleve/mineraleve për qëllime të ekspozimeve të tyre;	Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça,	Buxheti ⁴ 12,569.28
1.2	Prezantimi i kristaleve/mineraleve në Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucionalë për qëllime të promovimit të mëtejshëm të tyre	Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça,	13,087.44
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 4:		25,656.72
			BRK
			Produkti (Output)
			Mirëmbajtja dhe pasurimi i mëtejshëm me kristale dhe minerale si dhe provimi i tyre në vijimësi gjatë tere vitit 2023.
			Prezantimi i mëtejshëm i kristaleve dhe mineraleve para së paku 20 vizitave të ndryshëm në Muzeun si dhe pjesëmarrja në së paku 2 organizime/ evenimenteve tjera për qëllime të promovimit.

⁴ Buxheti është i përafërt // është kalkuluar duke marrë në konsideratë pagat e zyrtareve dhe derivate e shpenzuara për realizimin e aktivitetit në fjalë dhe do të mbulohej nga planifikimet e rregullta për paga dhe buxheti i alokuara në vitin 2023 në kategorinë mallra dhe shërbime. Prandaj, nuk pritet buxhet shtesë për të planifikimeve të rregullta buxhetore.

PLANI I PERFORMANCËS SË SHERBIMIT GJEOLLOJIK TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë (baseline)	Caku			
V.	Objektivi V: Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike si dhe bashkëpunimi dhe mbështetja e aktivitetit e karakterit zhvillimor në nivel vendor dhe ndërkombëtar					
1	Treguesi i performancës: Deri në mes të vitit (TM2 2023) të gjitha kapacitete teknike për analiza gjeologjike në SHGJK të funksionalizuara, si dhe deri në fund të vitit (TM4) të kemi përfaqësim përmbajtjesorë në së paku deri në 80% të gjitha aktiviteteve/ evenimenteve të karakterit zhvillimor te organizuara nga Shërbimi Gjeologjik i Evropës (EGS)	TM4 2023				
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti ⁵	Burimi i financimit	Produkti (Output)
1.1	Ngritja e kapaciteteve teknike për analizat gjeologjike	Të gjitha departamentet	TM1-TM4 2023	361,099.00	BRK	Kapacitetet teknike të SHGJK funksionale
1.2	Mbështetja e aktivitetit të karakterit zhvillimor, në nivel vendor dhe ndërkombëtar	Të gjitha departamentet	TM1-TM4 2023	30,000.00	BRK	Pjesëmarrja në takimet e EGS-së përfaqësim përmbajtjesorë
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 5:			391,099.00	BRK	

⁵ Buxheti është i përafërt // është kalkuluar duke marrë në konsideratë obligimet që barten nga viti 2022 për realizimin e projektit për funksionalizimin e pajisjeve laboratorike si dhe pagat e zyrtareve. Ky buxhet do të mbulohet kryesisht nga kategoria kapitale si dhe nga buxheti sipas planifikimeve të rregullta për paga dhe buxheti i alokuara në vitin 2023